

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA E KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	013
Nr. l faqave Br. stranica No. pages	3
Nr. Prot. Braj Prot. Prot. No.	2153
Data: Datum: Date:	29/06/2015
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku  
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 29 qershor 2015

Ref. nr. 261/013

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 92 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), nenin 6, paragrafi 1, pika 1.1, 1.7 dhe 1.13 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), si dhe në bazë të kërkesës së Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë (Nr. Prot: 2153, 25 qershor 2015), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për regjistrimin e studentëve në nivelin e parë të studimeve në vitin akademik 2015/2016 në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
2. Në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë në vitin akademik 2015/2016, në nivelin e parë të studimeve do të regjistrohen 2203 studentë (111 studentë nga komunitetet minoritare), prej të cilëve 1613 studentë në studime të rregullta dhe 590 studentë në studime me korrespondencë, në programet e akredituara në njësitë akademike si në vijim
  - 2.1. Fakulteti i Biznesit, Departamenti Administrim Biznesi - në studime të rregullta 300 studentë, në studime me korrespondencë 150 studentë.
  - 2.2. Fakulteti i Biznesit, Departamenti Administrim Biznesi (gjuhë boshnjake) - në studime të rregullta 100 studentë, në studime me korrespondencë 20 studentë.
  - 2.3. Fakulteti i Biznesit, Departamenti Kontabilitet dhe Financa - në studime të rregullta 300 studentë, në studime me korrespondencë 150 studentë.

- 2.4. Fakulteti Juridik, Departamenti Juridik i Përgjithshëm - në studime të rregullta 350 studentë, në studime me korrespondencë 150 studentë.
  - 2.5. Fakulteti i Menaxhmentit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, Departamenti Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri - në studime të rregullta 200 studentë, në studime me korrespondencë 100 studentë.
  - 2.6. Fakulteti i Menaxhmentit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, Departamenti Menaxhment në Turizëm (gjuhë boshnjake) - në studime të rregullta 30 studentë, në studime me korrespondencë 20 studentë.
  - 2.7. Fakulteti i Agrobiznesit, Departamenti Agroekologji dhe Agromjedis - në studime të rregullta 50 studentë.
  - 2.8. Fakulteti i Agrobiznesit, Departamenti Teknologji e prodhimit bimor - në studime të rregullta 50 studentë.
  - 2.9. Fakulteti i Agrobiznesit, Departamenti Teknologji ushqimore - në studime të rregullta 70 studentë.
  - 2.10. Fakulteti i Arteve, Departamenti Edukim në Muzikë - në studime të rregullta 20 studentë.
  - 2.11. Fakulteti i Arteve, Departamenti Edukim i Përgjithshëm në Muzikë - në studime të rregullta 20 studentë.
  - 2.12. Fakulteti i Arteve, Departamenti Edukim Artistik në instrumente frymore - në studime të rregullta 12 studentë.
3. Në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë në vitin akademik 2015/2016, në nivelin e parë të studimeve do të regjistrohen 111 studentë nga komunitetet minoritare (25 studentë nga komuniteti Boshnjak, 17 studentë nga komuniteti Turk, 23 studentë nga komuniteti Romë, 23 studentë nga komuniteti Ashkali, 23 studentë nga komuniteti Egjiptian), në programet e akredituara në njësitë akademike si në vijim:
- 3.1. Fakulteti i Biznesit, Departamenti Administrim Biznesi dhe Departamenti Kontabilitet dhe Financa - 3 studentë nga komuniteti Turk, 4 studentë nga komuniteti Romë, 4 studentë nga komuniteti Ashkali dhe 4 studentë nga komuniteti Egjiptian.
  - 3.2. Fakulteti i Menaxhmentit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, Departamenti Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri - 3 studentë nga komuniteti Turk, 5 studentë nga komuniteti Romë, 5 studentë nga komuniteti Ashkali dhe 5 studentë nga komuniteti Egjiptian.
  - 3.3. Fakulteti Juridik, Departamenti Juridik i Përgjithshëm - 8 studentë nga komuniteti Boshnjak, 4 studentë nga komuniteti Turk, 5 studentë nga komuniteti Romë, 5 studentë nga komuniteti Ashkali dhe 5 studentë nga komuniteti Egjiptian.
  - 3.4. Fakulteti i Agrobiznesit, Departamenti Agroekologji dhe Agromjedis dhe Departamenti Teknologji e prodhimit bimor - 6 studentë nga komuniteti Boshnjak, 4 studentë nga komuniteti Turk, 5 studentë nga komuniteti Romë, 5 studentë nga komuniteti Ashkali dhe 5 studentë nga komuniteti Egjiptian.


- 3.5. Fakulteti i Arteve, Departamenti Edukim në Muzikë dhe Departamenti Edukim i Përgjithshëm në Muzikë - 5 studentë nga komuniteti Boshnjak, 3 studentë nga komuniteti Turk, 4 studentë nga komuniteti Romë, 4 studentë nga komuniteti Ashkali dhe 4 studentë nga komuniteti Egjiptian.
4. Obligohet Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë të shpall konkursin për regjistrimin e studentëve në nivelin e parë të studimeve në vitin akademik 2015/2016, pas shpalljes së rezultateve të (ri)akreditimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe në përputhje me vendimet e saj.
5. Obligohet Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe me kërkesën e Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, (Nr. Prot: 2153, 25 qershor 2015), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



### Vendimi ju dërgohet:

1. Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
2. u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
3. Departamentit të Arsimit të Lartë, MASHT;
4. Agjencia e Kosovës për Akreditim;
5. Arkivit të MASHT.